



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1143

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Panelsite Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Bionics” SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të “KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS” sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me numër të prokurimit KEK-24-12107-1-2-1, me 06.01.2026, mori:

Vendim

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Bionics” SH.P.K. me nr. 2025/1143, e datës 22/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me numër të prokurimit KEK-24-12107-1-2-1.

II. Anullohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS” sh.a., ndërsaq aktiviteti i prokurimit: “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me numër të prokurimit KEK-24-12107-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.

III.. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

IV. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.11.2024, “KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS” sh.a në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me nr. të prokurimit: KEK-24-12107-1-2-1. Ndërsa me datën 07.11.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 € .

Me 11.11.2025, OE “Bionics” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. E cila me vendimin e AK me datën 13.11.2025 është refuzuar si te pa bazuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me 22/11/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Bionics” SH.P.K me nr. 2025/1143 për lidhur me aktivitetin “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me nr. të prokurimit: KEK-24-12107-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Bionics” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

- Me datën 29.01.2025 përmes platformës e-prokurimi na është kërkuar ti dorëzojmë dokumentet e përshtatshmërisë [bashkangjitur: Kërkesa për dokumentet e përshtatshmërisë - 29.01.2025.docx], të gjitha i kemi dorëzuar përmes platformës e-prokurimi me datën 31.01.2025, dhe origjinalin në zyrën e prokurimit të KEK. - Me datën 25.02.2025 na është kërkuar Vazhdimi i validitetit të ofertës dhe zgjatja e sigurimit të ofertës për 76 ditë Hera e parë, [bashkangjitur: 105-Kerkese për vazhdimin e validitetit_1.docx], të cilat i kemi dorëzuar me datën 26.02.2025 [bashkangjitur: Vazhdimi i validitetit te ofertes.pdf & Garancioni_Vazhdimt.pdf]. - Me datën 30.04.2025 na është kërkuar Vazhdimi i validitetit të ofertës për herë të dytë dhe zgjatja e sigurimit të ofertës për 92 ditë të tjera, [bashkangjitur: 105-Kerkese për vazhdimin e validitetit_2.docx], të cilat i kemi dorëzuar me datën 02.05.2025 [bashkangjitur: Vazhdimi i validitetit te ofertes 2.pdf & Vazhdimi i Garancionit 2.pdf]. - Me datën 05.08.2025 na është kërkuar Vazhdimi i validitetit të ofertës për herë të tretë dhe zgjatja e sigurimit të ofertës për 92 ditë të tjera, [bashkangjitur: Kërkesë për vazhdimin e validitetit_3.docx], të cilat i kemi dorëzuar me datën 06.08.2025 [bashkangjitur: Vazhdimi i validitetit te ofertës 3.pdf & Garancioni_3.pdf]. Pra në të gjitha 3 rastet kur AK ka kërkuar zgjatjen e validitetit të ofertës dhe garancionit të ofertës ne e kemi zgjatur për aq kohë sa është kërkuar edhe pse AK ka shkëlur nenin 40 pika 3 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, i cili thotë: Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahësimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet

brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Nga kjo shohim se AK në kundërshtim me rregulloren ka kërkuar zgjatje të validitetit 3 herë në një total prej 260 ditësh edhe pse e ka pasur vlerësimin e komisionit dhe aprovimin e u.d. të zyrës prokurimit në KEK qysh me datën 04.02.2025 [bashkangjitur: Raporti_Vlersimit_1.pdf], AK nuk ka vazhduar me shpalljen e fituesit sipas ligjit dhe procedurave por e ka prolonguar duke kërkuar vazhdimin e validitetit nga 60 ditë për 260 ditë, pra në total 320 ditë, dhe në fund ka dërguar vendimin për anulim. Me datën 07.11.2025 AK ka publikuar dokumentin për anulim [bashkangjitur: Vendimi i AK dhe Letrat Standarde.pdf], në të cilin na njofton se ky aktivitet i prokurimit anulohet me arsyetimin "1. Autoriteti Kontraktues anulon këtë aktivitet për arsye të pushimit të kërkesës për këtë furnizim. Me datën 10.11.2025 ne qasjen në dokumentet e dosjes së tenderit kemi parë se për këtë aktivitet të prokurimit ka pasur dy raporte të vlerësimit [bashkangjitur: Raporti_Vlersimit_1.pdf & Raporti_Vlersimit_2.pdf]. Në raportin e parë të vlerësimit të datës 22/01/2025 ne si kompani jemi shpallur të përgjegjshëm nga komisioni vlerësues dhe jemi rekomanduar për kontratë. Me datën 04.02.2025 u.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të prokurimit në KEK sha e aprovon propozimin e komisionit vlerësues. [bashkangjitur: Raporti_Vlersimit_1.pdf] Por çuditërisht në të njëjtin raport me datën 30.10.2025 (pas 268 ditësh!!!), u.d. i zyrës ekzekutive të prokurimit ka shënuar [shiko: Foto_1.pdf] mbi dokumentin i cili ka qenë i nënshkruar nga të gjitha palët, duke i tejkaluar kompetencat e tij ligjore pra duke ndërhyrë në mënyrë të jashtëligjshme në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve, i cili ka qenë dokument i përmbyllur dhe përfundimtar, e rikthen në mënyrë të jashtëligjshme dhe në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në rivlerësim dhe duke formuar komision tjetër të vlerësimit. Për më shumë veprimet e tilla janë në kundërshtim edhe me nenin 415 të kodit penal të Republikës së Kosovës sepse ndërhyrja në një dokument zyrtar (Raporti i vlerësimit) i cili prezanton një proces të vlerësimit të zhvilluar komfort dispozitave ligjore të LPP-së paraqet veprim të jashtëligjshëm - falsifikim dokumenti, meqë rast ekziston dyshimi i bazuar se janë konsumuar elementet e veprës penale, për të cilat ne do të marrim hapa tjerë ligjor në instancat përkatëse. Komisioni i ri i formuar ka bërë vlerësimin e ofertave [bashkangjitur: Raporti_Vlersimit_2.pdf], dhe duke na vlerësuar si të përgjegjshëm në të gjitha kriteret e ka rekomanduar për anulim këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin në përputhje me kërkesën e njësisë kërkuuese me arsye të tërheqjes (pushimit) së kërkesës për këtë furnizim, rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. me datën 05.11.2025 i cili aprovohet me datën 07.11.2025 nga u.d. Drejtori i zyrës ekzekutive të Prokurimit në KEK sha. AK me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 62 të LPP[1] së sepse ky nen në mënyrë eksplicite përshkruan rrethanat nën të cilat mund të anulohet një aktivitet i prokurimit siç janë citat: Neni 62 1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit 1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit." Pra në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjëra nga dispozitat e nenit 62 për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit, sepse oferta jonë është vlerësuar nga dy komisionet vlerësuese si

e përgjegjshme dhe brenda vlerës së parashikuar dhe e zotuar nga AK sipas Nenit 9 të LPP-së.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Bionics” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me - Nenit 62 të LPP-së (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit)- Neni 40 i Rregullores Nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin E Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve). Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që të merr: V E N D I M APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE Bionics SH.P.K. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve dhe nr. të prokurimit KEK-24-12107-1-2-1, dhe lënda të kthehet në rivlerësim për vendosje meritore.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim:

ANALIZA DHE SQARIMII KOMISIONIT TE VLERSIM: Pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi që, siç je eliminim, në përputhje me kërkesën e njësisë kërkuese për këtë furnizim, ky aktivitet i prokurimit është anulimit njoftuar edhe përmes letrës standarde për dhe për shkak të tërheqjes (pushimit) së kërkesës për këtë furnizim ky aktivitet i prokurimit është anuluar.

REKOMANDIM 1 KOMISIONIT TE VLERSIMIT: Rekomandohet Drejtori i zyrës ekzekutive të Prokurimit që kërkesa për rishqyrtim e OE “Bionics” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me nr. KEK-24-12107-1-2-1, të refuzohet si e pa bazuar.

KONKLuzion I DREJTORIT TE ZYRES EKZEKUTIVE TE PROKURIMIT: kërkesa për rishqyrtim e OE " Bionics SH.P.K." " Drejtor i zyrës ekzekutive të Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE “Bionics” SH.P.K i cili është i pa kënaqur me vendimin e autoriteti kontraktues si dhe bazuar në analizën, sqarimet dhe rekomandimin e komisionit të vlerësimit për aktivitetin e prokurimit “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me numër të prokurimit KEK-24-12107-1-2-1. REFWUZON si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Bionics” SH.P.K.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 25.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1143/2025, ndërsa me datë 09.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 1143/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth rekomandimit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Bionics” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1143 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigja e Ekspertit Shqyrtues

Nga shqyrtimi i Raportit të Komisionit të dytë të Vlerësimit rezulton se oferta e operatorit ekonomik është vlerësuar si e përgjegjshme në të gjitha kriteret, dhe se vlera e ofertës është brenda fondeve të zotuar nga Autoriteti Kontraktues, në përputhje me nenin 9 të LPP-së lidhur me parimin e sigurimit të fondeve.

Megjithatë, Komisioni i dytë ka rekomanduar anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u thirrur në një “kërkesë të njësisë kërkuese për tërheqje të kërkesës për furnizim”. Eksperti Shqyrtues sqaron se ky arsyetim nuk është i paraparë me asnjë dispozitë të LPP-së dhe nuk përbën bazë ligjore për anulim të procedurës pas përfundimit të vlerësimit.

Ligji për Prokurimin Publik përcakton qartë dhe në mënyrë taksative arsyet kur një aktivitet i prokurimit mund të anulohet. Një kërkesë e njësisë kërkuese e bërë pas fazës së vlerësimit nuk është arsye ligjore, dhe nuk mund të përdoret si bazë për të ndërprerë një procedurë të përfunduar dhe të vlerësuar në mënyrë të ligjshme.

Neni 62 i LPP-së përcakton vetëm tre rrethana të lejueshme për përfundimin e një aktiviteti të prokurimit që nuk rezulton në dhënien e kontratës:

Shkelje e ligjit në procedurë, të cilën nuk është e mundur të korrigjohet me amendament ligjor të kushteve të prokurimit;

Tejkalim substancial i buxhetit nga të gjitha ofertat e përgjegjshme;

Para hapjes së tenderëve, ndërprerja bëhet e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe të paparashikueshme.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi rezulton se:

Nuk është evidentuar asnjë shkelje e ligjit në procesin e parë të vlerësimit që do të duhej të çonte në anulim të detyrueshëm sipas pikës 1.1 të nenit 62;

Ofertat e përgjegjshme nuk e tejkalojnë buxhetin, përkundrazi janë brenda fondeve të zotuar;

Ndërprerja e procedurës nuk ka ndodhur para hapjes së tenderëve, por pas përfundimit të vlerësimit, çka e përjashton pikën 1.3 të nenit 62.

Prandaj Eksperti Shqyrtues konstaton se, në asnjërin nga këto pika nuk përfshihet “kërkesa e njësisë kërkuese”, prandaj një arsyetim i tillë nuk mund të përdoret ligjërisht si bazë për anulim. Si rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 62 të

LPP-së. Eksperti Shqyrtues rekomandon që ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në ri vlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me nr. të prokurimit: KEK-24-12107-1-2-1.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues . Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Bionics” SH.P.K janë të bazuara, kështu duke analizuar edhe procedurën në tërësi për çka AK-ja ka anuluar procedure në kundërshtim me nenin Neni 62 të LPP-së, me arsyetim se nuk i duhet më njësis kërkuese, derisa me datën 21.11.2024 AK-ja ka inicuar këtë procedure, duke tejkaluar kështu një vite të plotë dhe publikon B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-së me datën 07.11.2025 , pas një viti kalendarik kështu duke i tejkalur të gjitha afatet kohore të përcaktuara me LPP-në. Dhe një arsyetim pa ofruar prova as nga Zyrtari Kryesor Administrativë siq ka filluar procedura sikurse parashihet në nenin 22 të LPP-së , nuk ka ndonjë bazë ligjore për anulim arsyetimi i dhënë nga AK-ja tek publikimi i B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Liferimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e shpezëve” me nr. të prokurimit: KEK-24-12107-1-2-1, të anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

I shqiptohet vërejtje ZPP-së/ AK-së , duke kërkuar në të ardhmen në procedurat tenderuese ti përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të përcaktuara në LPP-së.

-Përfundim-

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II, dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - Bionics SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: